

Prof.Dr.Hfz
Hajredin Hoxha

INTERVISTA AKADEMIKE MBI PEDAGOGJINË, EDUKIMIN, FAMILJEN DHE SHOQËRINË



PËRMBAJTJA

Pjesa I.....	5
PËRGJIGJE AKADEMIKE DHE FETARE NGA PROF.DR.HFZ HAJREDIN HOXHA, PËR PYETJET E PARASHTRUARA NGA STUDENTËT E NIVELIT MASTER PRANË FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME NË PRISHTINË	5
01. Sa është vështirësuar edukimi i familjes tradicionale-islame në kohën dhe jetën bashkëkohore?	6
02. Sa është i rëndësishëm reputacioni moral dhe roli edukativ i gruas (nënës) në edukimin e familjes në përparimin e shoqërisë bashkëkohore?	8
03. Sa është me rëndësi relacioni i jetës bashkëshortore për zhvillimim e familjes dhe përparimin e shoqërisë?	11
04. Sa ndikon sipas mendimit tuaj roli edukativ i bashkëshortes në forcimin e karakterit social dhe atë shpirtërorë të bashkëshortit?	14
05. Sa e sfidoi koha bashkëkohore jetën socio-edukative dhe socio-ekonomike familjen tradicionale-islame?	16
06. A është e sfiduar shoqëria në aspektin socio-edukativ me mungesën e edukimit fetar në shkollat publike?	19
07. Cilat janë pasojat e mungesës së mësim-besimit në shkollat publike?	22
08. Cili është qëllimi i zhvillimit të mektebit nëpër xhamia dhe çka përfiton shoqëria me zhvillim të mektebit?	26

09. Sa ndikuan sfidat e teknologjisë moderne ndaj familjes tradicionale? Sa është ndikimi i teknologjisë elektronike siç janë: televizori, interneti, rrjetet sociale etj., dhe cilat janë pasojat sipas jush?..... 29
10. Sa ka ndikuar jetesa moderne ndaj familjes tradicionale si psh: mungesa paraprake e edukimit martesor, bashkëjetesa pa kurorë, bashkëjetesa me prindërit apo në familje të zgjeruar, etj., dhe cilat janë pasojat e së ardhmes sipas jush?32
- Pjesa II 35
- PËRGJIGJE AKADEMIKE, FETARE, EDUKATIVO ARSIMORE NGA PROF.DR.HFZ HAJREDIN HOXHA PËR PYETJET HULUMTUESE NGA STUDENTËT KOSOVARË NË NIVEL TË DOKTORATURËS NË UNIVERSITETIN NDËRKOMBETAR TË NOVI PAZARIT..... 35**
01. Si mendoni pas adhurimit ndaj Zotit a është gjëja më me vlerë koncepti pedagogjik i njeriut (edukim dhe arsimim), dhe a mund të themi se njeriu pa edukim pedagogjik është i mangët në adhurime ndaj Zotit?37
02. Sa ka ndikuar pedagogjia dhe civilizimi islam në pedagogjinë dhe civilizimin global gjatë historisë?40
03. Cilat janë ato cilësitë dalluese të sjelljes së Pejgamberit a.s., që cilësohet nga Zoti xh.sh., si krijesë me virtyte më të larta pedagogjike?43
04. Sa ka ndikuar pedagogjia e Pejgamberit a.s., në edukimin njerëzorë gjatë historisë?..... 46

05. Cili është qëllimi i edukimit dhe arsimimit të shoqërisë, dhe a ka perspektivën e së ardhmes një shoqëri pa edukate të mirëfilltë dhe arsimim cilësorë? 49
06. A mund të themi se edukimi pedagogjiko-fetar është i prapambetur siç deklarojnë disa modernistë, dhe çfarë janë dobitë e edukimit fetar? 52
07. Sa është me vlerë edukimi i shpirtit dhe të zemrës, dhe sa duhet përkushtuar vëmendjen në këtë gjë? 56
8. A është përmirësuar roli dhe pozita e gruas në familje dhe në shoqëri në këtë kohë bashkëkohore në Botën arabe? 59
9. A mund të na thoni sa është roli i Bashkësisë Islame në edukimin e shoqërisë kosovare, me anë të institucioneve të saja si Mektebet, Medresetë, Fakulteti, Shkollat e Kuranit e Bibliotekat, dhe me anë të publikimeve siç janë Edukata Islame, Dituria Islame, Takvimi, etj. 63
10. Sipas mendimit tuaj kush janë pedagogë islam që kanë lënë gjurmët më të mëdha në histori të Kosovës, por edhe atë globale gjatë historisë Islame. (T'i numëroni së paku 5-10 vendor, (dijetarë, intelektual) dhe 5-10 botërorë të shquar në historinë islame por edhe tani në kohën bashkëkohore.) 68

PJESA I

**PËRGJIGJE AKADEMIKE DHE
FETARE NGA PROF.DR.HFZ
HAJREDIN HOXHA, PËR
PYETJET E PARASHTRUARA
NGA STUDENTËT E NIVELIT
MASTER PRANË FAKULTETIT
TË STUDIMEVE ISLAME NË
PRISHTINË**

01. SA ËSHTË VËSHIRËSUAR EDUKIMI I FAMILJES TRADICIONALE-ISLAME NË KOHËN DHE JETËN BASHKËKOHORE?

Sa i përket edukimit të familjes në jetën dhe kohën tonë aktuale, nuk bëjmë ekzagjerim nëse aludojmë me këtë përgjigje të shkurtë dhe specifike: Edukimi i familjes në frymë islame në këtë kohë që po jetojmë (shek. 21) është sfida më madhe që kemi hasur ndonjëherë përgjatë historisë, dhe është bërë pothuajse ëndërr e çdo prindi që shumë vështirë e ka me e realizua atë.

S'do mend se edukimi i familjes është ndër prej obligimeve të mëdha islame. Rëndësia e këtij obligimi është potencuar në shume ajete kur'anore dhe hadithe të Muhamedit a.s. Po ashtu nuk duhet harruar se armiqtë e fesë islame si në të kaluarën po ashtu dhe në kohën tonë bashkëkohore kanë përdorur metoda të ndryshme anti islame dhe antihumane për degjenerimin e familjes muslimane në radhë të parë, sepse me shkatërrimin dhe degjenerimin e familjes shkatërrohet shoqëria muslimane, dhe kur shkatërrohet shoqëria, së këndejmi automatikisht shkatërrohet edhe shteti. Pasojat e këtij shkatërrimi dhe degjenerimi social, familjar dhe individual vërehen qartazi në fushën apo aspektin politik, akademik, fetar dhe social, ku sot ti has dhe sheh (x) persona jo të moralshëm, pa karakter, pa parime fetare, pa edukim të mirëfilltë, po arsimim, pa prodhim, po kursim, pa kreativitet, pasiv, pas asnjë veti njerëzore pozitive!!

Është për t'u tmerruar me numrin e atyre vajzave apo djelmoshave që bredhin rrugëve nëpër kafene e qendra tregtare, nëpër klube dhe bare të natës!! E tërë kjo është mungesë e edukimit familjar, e prishjes së folesë familjare, mungese e edukimit të shëndoshë fetare dhe civil të çiftit të posa martuar, pa kurse paramartesore për trajnimin e dy çifteve për obligimet dhe të drejtat e tyre reciproke martesore, si nga aspekti religjioz islam, po ashtu edhe aspekti civil, social e ligjor. E tërë kjo zbrazëtirë rezulton në gjendjen kaotike dhe mjeruese dhe të tmerrshme që sot jemi dëshmitarë të këtij fenomeni negativ për fat të keq. Nuk duhet harruar edhe agjendat globale të masonëve në vende të ndryshme botërore që kontrollojnë mediat dhe publiciteti, ekranet televizive dhe rrjetet sociale të internetit, me tematikat, reklamat e tyre zbavitëse, dëfryese, shkatërruese, degjeneruese, shfrenuese, të kota, pa vizion, pa mision, filmat kriminale me dhunë familjare, mbyetje, divorce, trafikim njerëzor, drogat etj etj. Këtu në këtë kontekst nuk duhet harruar edhe rolin e vdekur institucional akademik, fetar, qeveritar, politik të shtetit tonë i cili në këtë drejtim nuk vepron sa duhet me tërë potencialin dhe kapacitetin e tyre për t'i luftuar këto dukuri negative mediatike që ndeshen me bazat dhe fundamentet fetare islame, e parimet njerëzore morale dhe sociale, në mënyrë që t'i shpëtojmë fëmijët tanë nga kjo humnerë. E tërë kjo çka u tha e vërteton teorinë dhe mendimin tonë të lartëpërmendur për sfidën që jemi duke u ballafaquar në edukimin e familjes, Allahu na ndihmoftë me dal nga kjo krizë. Amin amin amin.

02. SA ËSHTË I RËNDËSISHËM REPUTACIONI MORAL DHE ROLI EDUKATIV I GRUAS (NËNËS) NË EDUKIMIN E FAMILJES NË PËRPARIMIN E SHOQËRISË BASHKËKOHORE?

Reputacioni moral dhe fetar i nënës luan rol shumë të madh dhe të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve. Për të pasur fëmijë dhe familje të shëndoshë pejgamberi ynë Muhamedi a.s. na ka urdhëruar dhe na ka mësuar që nga fillimi i kurdisjes së bërthamës familjare të shëndoshë të kemi kujdes në përzgjedhjen e shokut /shoqes së jetës, duke na mësuar dhe duke na udhëzuar se vajza/djali është para disa opsioneve/kritereve që duhet të ketë parasysh kur dëshiron të lidhë kurorë me dikë. Ato kritere/kushte/cilësi Muhamedi a.s. na ka bërë me dije se gruaja/vajza/burri/djali mund të martohen për këto katër qëllime/kritere: a- për pasurinë e saj/tij, b- për fenë dhe moralin e saj/tij, c-për bukurinë e saj/tij d-pozitën familjare të saj/tij. Pastaj vazhdon Muhamedi a.s. duke konkluduar: të kesh kujdes! Martoje atë grua/vajzë/burrë/djalë që ka fenë dhe moralin e tij/saj në nivel të mirë e të pranueshëm (normal perfekt është vetëm Allahu xh.sh.), përndryshe keni për të humbur shumë dhe do të gaboni shumë nëse anashkalohen këto këshilla profetike, dhe sherri do të jetë me përmasa të mëdha. Mungesa e reputacionit moral islam i gruas/nënës vërehet edhe në pasojat që vijnë:

Është dëshmuar historikisht dështimi i martesave të muslimanët por edhe të tjerët të cilët janë martuar jo për qëllime fetare apo

morale. Po ashtu edhe sot e kësaj dite vazhdon kjo dukuri negative në shkatërrimin e familjeve, ku rastet e divorcit në Kosovë dhe trojet shqiptare janë alarmuese! Pa kaluar një muaj, një vit, ndoshta edhe një javë kur dëgjon se filan çifti (X+Y) janë ndarë!! Kanë dhënë fund martesës së tyre! Situata është tmerr për vajzat dhe djemtë tanë. Kultura e globalizmit perëndimor dhe atij amerikan është kah na vërshon me të madhe dhe fuqishëm.

Mediat globale, lokale, serialet e ndryshme kanë vërshuar furishëm shtëpitë tona. Kinematografia shturëse në të cilën promovohen antivlerat ka pushtuar shtëpitë tona! S'ka censurë për asgjë! Tmerr e zi në çdo aspekt! Populli dhe rinia pa imunitet fetar dhe moral, pa edukatë familjare janë bërë pre e lehtë dhe viktimë e lezetshme për armiqtë e fesë islame dhe të muslimanëve. Qeveritë dhe liderët tanë laikë dhe neutral në këtë drejtim!! Fare nuk po iu intereson kjo gjendje katastrofike që na ka kapluar. Po ashtu edhe institucionet fetare nuk janë duke punuar mjaftë në këtë drejtim me kurse, me seminare, me programe, me konferenca, me ligjërata, me debate televizive si të tjerët, nuk janë rival apo opozitë e atyre të këqijve, dhe së këndejmi jemi bërë të pavlerë dhe pa rëndësi për ta, përkundër faktit dhe realitetit 95% të popullsisë kosovarë janë musliman. Ata s'po ndalen nga e keqja dhe sherri, e ne me duar të lidhura në gjoks, at këtu rrallë herë, në mënyrë private dhe individuale janë disa që flasim për rrezikun që na ka kapluar nga të katër anët. Nëse ata punojnë për keq, ne duhet ti sfidojmë ata me këmbëngulje dhe fuqishëm duke e mbrojtur identitetin tonë fetar islam me tërë potencialin që kemi,

përndryshe ditë më të rënda do të na vijnë, dënime më të rënda për këtë krim fetar dhe njerëzor të neglizhuar prej nesh.

03. SA ËSHTË ME RËNDËSI RELACIONI I JETËS BASHKËSHORTORE PËR ZHVILLIMIN E FAMILJES DHE PËRPARIMIN E SHOQËRISË?

Normal, nëse respektohen ato principe, rregulla, kritere, urdhra të Muhamedit.a.s. në përzgjedhjen e shoqes/ gruas/ shokut/ bashkëshortit / dmth, kriteri fetar dhe moral është primar dhe fundamental, relacioni bashkëshortor do të forcohet dhe të ketë fryte pozitive.

Sepse këtu lind dashuria e vërtetë për Allahun dhe në emër të Allahut, bahet bashkimi i dy qifteve për ta aritur pëlqimin e Allahut me këtë kurorë, lidhje bashkëshortore të shenjtë, ku këta të dy janë bërë hallall me emrin e Allahut xh.sh., për njeri tjetrin për ta gjetur qetësinë shpirtërore, fizike dhe psikike, ku të dy palët e mëshirojnë dhe e kompletojnë njeri tjetrin, dhe anasjelltas, nëse ky relacion bashkëshortor ndërtohet me dashuri romantike të serialeve apo të filmave që mediat po trumbetojnë me të madhe ditë e natë për këtë model dhe për këtë stil martesor modern, këtu nuk mund të lind dashuria e vërtetë dhe së këndejmi nuk mund të formohet përgjegjësia reale afatgjate që është një ndër objektivat më kryesore të martesës islame, sepse sipas islamit çdo veprë që vepron Muslimani në emër dhe për emër të Allahut, ajo shpërblehet dhe konsiderohet ibadet, ku edhe mardhëniet seksuale në mes të dy çifteve konsiderohet ibadet, dhe se ky realitet apo motiv është faktori dhe sekreti më i fortë për të

vazhduar relacioni bashkëshortor për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë.

Po ashtu këtu duhet cekur përgjegjësinë qeveritare dhe të institucioneve sociale dhe fetare islame për ta përforsuar këtë relacion bashkëshortor dhe familjar që është dobësuar dukshëm këto ditë. Kjo përgjegjësi realizohet duke organizuar takime, debate, seminare, konferenca, duke shtypur dhe distribuar broshura, libra, duke organizuar programe edukativo-arsimore rreth martesës, kurse paramartesore obligative (me provime dhe teste, libra referenca) etj. Në këtë mënyrë zhvillohet dhe përforsohet relacioni bashkëshortor, edukohen çiftet para martesës, dhe si rezultat i këtyre aktiviteteve do të përforsohet mirëkuptimi, relacioni dhe dashuria bashkëshortore.

Përndryshe, nëse vazhdojmë me këtë gjendje të mjerueshme dhe të tmerrshme aktuale të relacionit bashkëshortor dhe familjar, vaj halli dhe kuku për ne dhe për shoqërinë tonë, dhe në fund kuku për ardhmërinë e shtetit tonë në aspektin politik, akademik, fetar dhe social.

Në këtë kontekst mediat shqiptare kosovare dje me datën 4 Janar 2022, lajmet e mbrëmjes e dëgjova lajmin shokues dhe tronditës!! Lajmi ishte se shkatërrimet dhe divorcet familjare në Kosovë gjatë vitit 2020 kanë mbërri 1600 raste të evidentuara, të moshave 19-25 vjeç. Në mes tyre ishin edhe 49 raste të moshës 60-65 vjeç që i kanë dhënë fund jetës martesore!! O Allah udhëzoje këtë popull shqiptar musliman në rrugën Tënde, dhe në rrugën e Muhamedit

a.s. O Allah na mundëso që të kemi lider të denjë politik dhe fetar për të na shpëtuar nga kjo gjendje e tmerrshme e cila e ka kapluar vendin tonë dhe familjet tona, amin, amin, amin.

04. SA NDIKON SIPAS MENDIMIT TUAJ ROLI EDUKATIV I BASHKËSHORTES NË FORCIMIN E KARAKTERIT SOCIAL DHE ATË SHPIRTËRORË TË BASHKËSHORTIT?

Përgjigjja e kësaj pyetje ka lidhshmëri të fortë me pyetjet dhe përgjigjet paraprake. Normal që roli i shoqes së edukuar ka për të ndikuar pozitivisht në karakterin personal, shpirtëror por edhe profesional dhe social të bashkëshortit. Nëse ajo nanë, shoqe, bashkëshorte është me karakter fetar, edukativo-arsimor të mirë, moral, social të shëndoshë, s'do mend që ajo do të luaj rolin pozitiv psikikisht dhe moralisht të shëndoshë në përforcimin e personalitetit të bashkëshortit të saj dhe suksesit të tij. Këtu kuptohet mençuria dhe sekreti i kriterit të moralit që pejgamberi a.s, e ka përmend para 14 shekujve në prag të përzgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes. Çfarë po shohim sot te gjeneratat e reja dhe sjelljet e tyre jo edukative është tmerr e zi!! Si në botën arabe ashtu edhe në trojet tona shqiptare dhe gjetiu ku disa çifte nuk janë të ujditura me njeri tjetrin, nuk përputhet ADN-ja dhe kimia e gjakut të tyre dhe si pasojë nuk kanë muhabet e respekt, dhe kështu vjen situata gjer te ndarja apo shkatërimi i kësaj strolle që feja islame e ka kërkuar ruajtjen e saj me çdo kusht dhe e ka konsideruar një ndër prioritetet islame të mëdha. Para furtunave të modernizmit global, para kulturës perëndimore dhe amerikane, para të zezave mediatike në emër të globalizmit dhe të emancipimit post-modern, roli i bashkëshortes me parime dhe etika njerëzore pozitive në përforcimin e karakterit social,

shpirtëror dhe profesional ka qenë shumë i madh dhe i fortë, për arsye të përkufizimit kulturor të saj ku shembull konkret i kemi nanat tona dhe kulturën e tyre të pastër e të singertë. Ajo nuk ka qenë e ekspozuar për media aktuale, ajo vetë personalisht nuk ka pas qasje me kulturat e huaja, dhe kjo traditë konzervative ka qenë e mirëseardhur dhe kemi qenë dhe jemi krenar me këso lloje apo tipa të bashkëshorteve, nanave dhe motrave tona. Ilustrimi me konkret për rolin pozitiv që mundet me e luajtë gruaja/ shoqja/ bashkëshortja/ e kemi në rastin dhe shembullin e hazreti Hatixhës me pejgamberin tonë Muhamedin a.s. kur ai u kthehej në shtëpi i zhgënjyer, i lodhur, i mërziur, i ofenduar, i luftuar nga populli dhe fisi kureshit në Mekke në fillim të davetit të periudhës islame, ai u kthente në prehër të bashkëshortes së tij Hatixhës r.a. dhe ajo e qetësonte, e këshillonte, e përkdhelte, i jepte kurajo, ia lehtësonte brengat e tij duke i thënë: Allahu nuk ka për të humbur..Allahu nuk ka për të poshtëruar..ti i ndihmon të varfërve, i ushqen musafirët dhe je bujar etj etj...dhe kështu Muhamedi a.s. përforcohej dhe freskohej sërish për misionin e tij të shenjtë. Kemi edhe raste tjera por hapësira e përgjigjeve është e limituar, dhe Allahu xh.sh. e di më mirë.

05. SA E SFIDOI KOHA BASHKËKOHORE JETËN SOCIO- EDUKATIVE DHE SOCIO-EKONOMIKE FAMILJEN TRADICIONALE-ISLAME?

Sa i përket sfidave bashkëkohore, rrymave dhe kulturave globale që na kanë sulmuar dhe pushtuar në çdo fushë dhe kënd të jetës, e tërë kjo gjendje e mjerueshme e ka vështirësuar jetën e familjes në aspektin socio-edukativ dhe socio-ekonomik tradicional islam. Mospërfillja e parimeve kur'anore dhe atyre profetike në jetën tonë të përditshme si në aspektin politik, ekonomik, social, familjar, moral, institucional etj., e tërë kjo e ka kompleksuar dhe e ka sfiduar jetën tradicionale islame në jetën tonë familjare. Në këtë kontekst duhet sçaruar opinionit të gjerë publik se për ta shpëtuar veten dhe popullin tonë shqiptar kudo që të jenë, dhe për ti përballuar këto sfida e shohim imperativ kohor që parimet dhe vlerat islame (kur'anore dhe profetike)të aplikohen në mënyre masovike dhe univerzale dhe të integrohen në tërë sferat jetësore. Për ta realizuar këtë obligim dhe imperativ kuranor dhe kohor na duhen urgjentisht reforma pozitive në sistemin e lidërshiptit politik, ekonomik, akademik, fetar, familjar, social dhe ai ndividual. Këto shtigje dhe fusha të reformave urgjente fetare dhe politike kanë të bëjnë me reforma në përmbajtjen dhe prezentimit të diskursit fetar (çfarë islami po shërbejmë, dhe çfarë duhet shërbyer ? kujt po i shërbejmë? A jemi shërbyes të Islamit-el Khadimune lil Islam – apo përfitues dhe përdorues të Islamit – el Mustekhdimune lil Islam)?, dmth, të korrigojohet (stili,

aktualiteti i tematikave të ligjëratave dhe përgatitja profesionale e ligjërueseve), po ashtu edhe në diskursin akademik dhe atij politik. Për këtë iniciativë të reformave duhet të koordinohen mekanizmat qeveritare shtetërore dhe institucionet fetare islame (Bashkësia Islame e Kosovës-BIK-ut), duke i bashkuar dhe koordinuar plan programet dhe misionet e tyre intelektuale dhe shkencore për rëndësinë e këtyre reformave për ta shpëtuar popullin nga kjo gjendje e mjerueshme. Parimet islame hyjnore të shpallura në Kur'an dhe Synet nuk kanë kontradikta me parimet dhe fundamentet e shëndosha të sistemin politik apo ekonomik bashkëkohor – ne nuk jemi laik apo sekular siç janë besojnë dhe deklarojnë të tjerët: që feja islame nuk lidhje me politikë!! Përkundrazi. Po të ia hedhim një shikim të shpejtë mësimëve kur'anore dhe atyre profetike, dhe po të ia bëjmë një analizë të thuktë legjislacionit tonë Islam do të shohim se esenca e tematikave fetare islame, objektivat e parimeve islame dhe dimensionet e tyre humane dhe sociale pajtohen me objektivat e përgjithshme të mirëqenies njerëzore, social, familjare dhe individuale. Krejt në fund këto reforma për tu futur në aksion apo praktikë, strategjia e shëndosh kërkon që ne duhet që sa më shpejt to formojmë, themelojmë parti politike me programe dhe plane konkrete, me mision dhe vizion dhe transparence islame aktuale, ku nëpër mjet deputeteve(hoxhallarë intelektual, profesor të medreseve, profesor te FSI-së) të sinqertë intelektual dhe punëtorë, të përzgjedhur me merita dhe me parimet demokratike bashkëkohore në parlament të shtetit tonë, që të ndikojmë pozitivisht në ndryshimin e disa ligjeve të kushtetutës

shtetërore karshi fesë islame, apo feve në përgjithësi, në mënyrë që opozita politike antifetare ta ulin tonin e zërit e tyre anti fetar dhe jo demokritik,e në veçanti anti islam, të bëhen disa ndryshime kushtetuese, të rregullohen disa probleme ligjore jo të fiksuara, sa i përket futjes së mësim besimit islam apo fetar nëpër shkollat tona, të mos pengohen vajzat,motrat, gratë tona me shamija, të luftohet korrupcioni fetar, politik, akademik, narkomania, amoraliteti, papunësia, mediat me tematika dhe vlera anti njerëzore, anti fetare. Dmth, pa u integruar edhe në politikë këto reforma dhe këshilla kur'anore nuk mundën të realizohen me këtë metodë dhe me këtë stil predikimit aktual, të praktikimit pasiv dhe shërbimit sekondar të fesë islame.

Allahu na mundësoftë që ne ti shërbejmë Islamit ashtu si duhet, dhe jo të përfitojme prej tij për interesa personale, amin amin amin.

06. A ËSHTË E SFIDUAR SHOQËRIA NË ASPEKTIN SOCIO-EDUKATIV ME MUNGESËN E EDUKIMIT FETAR NË SHKOLLAT PUBLIKE?

Shoqëria islame/muslimane shqiptare, turke, boshnjake, rome është sfiduar shumë sa që nuk mund ta imagjinosh dëmin dhe pasojat negative të kësaj mungese shpirtërore, akademike dhe fizike. Sa për ilustrim po i përmendim disa pasoja dhe dukuri negative të mungesës së edukimit fetar në shkollat tona publike: përhapja e vrasjeve, kidnapimeve, dhunës seksuale, korrupsionit edukativo-arsimor (me blerjen e diplomave, publikimin e pyetjeve të provimeve), mungesa e sigurisë së përgjithshme, droga, martesat e përziera me ithtarët e fesë katolike apo ortodokse, hebreje në vendin tonë apo në diasporë, (ku vajzat tona muslimane janë martuar me ushtarët e NATO's dhe vazhdojnë akoma sot e kësaj dite), prindërit pothuajse nuk konsultohen fare dhe se qëndrimi i tyre është formal dhe simbolik dhe nuk kane ndikim te fëmija e tyre për arsye të kulturës globale antiislame dhe të mungesës së edukatës fetare në shkollat publike: Shkurorëzimet, abuzimet familjare dhe shoqërore, mungesa e kulturës fetare dhe të asaj civile apo ligjore, kulturës martesore islame në përgjithësi dhe asaj seksuale islame në veçanti, humbja e turpit/marres para anëtarëve familjarë, ku hasish brenda në një familje, ku vëllau apo motra, apo prindërit vishen me rroba jo të traditës islame apo muslimane, me shorte, fustane mini, me brekë, dhe e tërë kjo shihet normale, sepse këto

stile i shohin në dramet dhe serialet televizive meksikane, turke, amerikane, angleze, franceze, ku edhe moderatores femra në debate televizive lokale shqiptare në Kosovë apo Shqipëri dalin shumë seksi duke ekspozuar pothuajse tërë trupin e tyre para publikut, qëllimisht me uljet e tyre provokative në karriga, me qëllim të tërheqjes së vëmendjes së publikut dhe në emër të emancipimit dhe të demokracisë, jeta private e tyre me qenë, me egërsira, etj, etj. Ma e keqja e kësaj është se kjo gjendje sociale dhe morale e ka vdek në shpirtërat dhe zemrat e shqiptarëve muslimanë sensin e urrejtjes së keqes dhe të haramit, kjo gjendje e rëndë e ka çrrënjosë nga zemrat dhe gjuha e tyre ndalimin nga e keqja dhe urdhëresën në të mirë, sa që jemi ba si disa gjenerate të hershme të Beni Israilëve (ithtarët e hershëm në kohën e Isait dhe të Davudit a.s.) të cilët i ka mallkuar dhe i ka dënuar Allahu xh.sh. për mos ndalimin nga e keqja dhe mosurdhëresën në të mirë. Aq shumë janë paraqitur pasojat dhe dukuritë negative sa që është e pamundur me e përmend një dukuri apo traditë pozitive të mirë në këtë kohë post-moderne të " emancipuar, të avancuar ". Prej pasojave negative është reduktuar dashuria vëllazërore nëpër familje, shoqëri, fafesisni, nuk kanë dëshirë dikush me i vizitue, ti vet ndoshta nuk ke dëshirë për vizitë, vëtëm në raste të vdekjeve apo martesave shihen, ndonjëhere edhe gjatë Bajrameve, janë ngushtuar zemrat e muslimanëve ndaj njeri tjetrit, është shishmuar vetmia dhe egoizmi shtazarak (normal me përjashtime të vogla), etj, etj.

Kush fajësohet për këto të zeza? S'do mend se fajin më të madh e ka qeveria e shtetit, pastaj Institucioni ynë fetar (BIK-u) me tërë stafin dhe institucionet që posedojnë (Fakulteti i studimeve islame, medresetë, 800 imama në 800 Xhami të Kosovës për mos angazhimin e tyre maksimal, për mos realizimin e reformacioneve të lartëpërmendura, për mosluftimin dhe mos rezistencën e tyre para qeverisë dhe para publikut të gjerë.

Si të dalim nga kjo krizë? Nga gjendje e mjerueshme dalim duke i ringjallë ndjenjat e muslimanëve shqiptarë, të qeveritarëve dhe të deputetëve tanë musliman shqiptarë në qeveri, me parti politike islame, reformacione të institucioneve tona publike fetare, me protesta nëpër rrugë dhe në palament për këtë gjendje alarmante, me reforma ne diskutim e tyre fetar, social dhe politik, me ringjalljen e vlerave tona kombëtare dhe atyre fetare tradicionale, dhe morale. Pa e ndryshu na vet gjendjen tonë, ndryshimi pozitiv nuk vjen, dhe Allahu nuk na e ndryshon gjendjen tonë pa iniciativën tonë. Ky është vizioni Kur'anor dhe ai profetik. Allahu na ndihmoftë...amin amin amin.

07. CILAT JANË PASOJAT E MUNGESËS SË MËSIM-BESIMIT NË SHKOLLAT PUBLIKE?

Mësim besimi në shkollat publike sipas mendimit tim konsiderohet mungese shpirtërore, morale, edukativo-arsimore, akademike, sociale, ekonomike dhe politike, dhe pasojat e kësaj mungese janë të shumta dhe me përmasa të mëdha që vërehen publikisht dhe qartë pa koment. Në pikat që vijojnë po i përmendim disa shembuj të këtyre pasojave:

- **A. Pasojat shpirtërore:**

vërehet qartazi mungesa apo ngritja e mëshirës/rahmetit nga populli pjesërisht/krejtësisht, humbja e respektit në aspektin social dhe familjar! Nuk ka dhimbje dhe gajlosje për njeri tjetrin, s'ka dashuri, s'ka sinqeritet, s'ka dashuri, s'ka solidaritet shpirtëror as solidaritet financiar! Po ku ti gjejmë këto vlera të humbura? Këto vlera gjinden në zemrën e Muslimanit që ka frikën e Allahut xh.sh. Kjo frikë vjen nga edukimi i mirëfilltë familjar dhe arsimor. Por pasi që edukimi fetar në shkolla publike nuk funksionon dhe parimet fetare nuk figurojnë në tekstet dhe kurikulat shkollore, atëherë çfarë pritet prej gjeneratave aktuale?! Po ashtu kjo frikë e individit nga Allahu xh.sh. reflekton nga zemra e tij dhe demonstron në sjelljen dhe moralin e tij gjatë shitblerjes, në marrëdhënie sociale të ndërsjella në shkollë, rrugë, shtëpi e kështu me radhë. Kjo situatë aktuale nuk është në favorin tonë, dhe për fat të keq jemi tjetërsuar dhe shndërruar në shoqëri

materialiste, egosite, kapitaliste ku interesit personal i jepet prioritet para interesit kolektiv etj.

- **A. Pasojat morale:**

degjenerimi dhe asimilimi moral i rinisë sonë, narkomania, vrasjet, abuzimet familjare dhe bashkëshortore, rastet shokuese të vrasjeve familjare, ikjet e të rinjve dhe të rejave prej gjirit familjar, neglizhenca e kujdesit të fëmijëve ndaj familjes dhe prindërve të moshuar ku vërehet kërkesat masive për shtëpi, apo shtëpi të pleqve, strehimore, qendra rehabilituese. Në anën tjetër prostitucioni dhe krimi i organizuar, përdhunimet, homoseksualizmi, feminizmi, stili perëndimor dhe ai amerikan në veshmbathje, në ushqim, në të folur, përdorimi i fjalëve të ndyta në të folur, në ofendime, në sharje etj.

- **C. Pasojat edukativo-arsimore:**

sekularizmi global dhe ai lokal, ofendimet ndaj Islamit dhe të muslimanëve (kjo dukuri vërehet qartazi nëpër mediat tona dhe rrjetet sociale, ku në fokus është Islami dhe muslimanët, a ndërsa sulmi ndaj religjioneve tjera nuk vërehet fare dhe mediat dhe rrjetet sociale nuk i marrin si tema diskutimi dhe nuk i sulmojnë absolutisht), etiketimi i Islamit dhe i Muslimanëve me terorizëm, vërehen qartazi dukuri skeptike dhe të dyshimta gjatë biznesëve si p.sh. kohëve të fundit në Kosova me " BITCOIN " dhe përdorimi i rymës ilegalisht, shpërlarje parash, tranzakcionet e ndaluara në Islam" PARA ME FAIDE", " BLERJA DHE SHITJA E DIPLOMAVE " të

nivëleve të ndryshme akademike, pastaj edhe punësimi në saje të atyre kualifikimeve ilegale të falsifikuara të korrupuara. Po ashtu vërehet dobësia e kualitetit arsimor dhe shkencor: sheh rininë, të ritë dhe të rejtat janë nëpër fakultete dhe kolegje (shkenca sociale apo humane) nuk dinë dhe nuk varin vesh asgjë për zanatin dhe profesionin e tyre !! Shumë rrallë janë ata të cilët janë të kualifikuar dhe të arsimuar në profesionin e tyre, etj etj. Ma shkurt situatë mjeruese dhe tmer e zi, e sidomos në këtë pandemi të COVID -19, ku mësimet vijohen online, ku provimet zhvillohen online. Ku mundësia e vjedhjes së përgjigjeve është e mundur 90 % !!

- **D. Pasojat sociale:**

Dobësia e solidaritetit vëllazëror, varfëria e madhe, papunësia e madhe, gjendja ekonomike dhe financiare e qindra familjeve është mjeruese dhe prekëse në zemër!! Shifni p.sh. rastet e familjeve pothuajse të paralizuara dhe të vdekura nga uria dhe veshmbathja në emisionet: JETIMAT E BALLKANIT, EDHE NE JEMI NË KOSOVË etj, ku vërehet kjo pasojë e solidaritetit human e fetar. Muslimanët dhe biznesmeneët shqiptarë në Kosovë dhe gjetiu pjesa dërmuese nuk dinë pothuajse asgjë për obligimin fetar të dhënies obligatgive 2.5 % të ZEKATIT, dhe kjo mungesë edukative fetare nëpër shkollat tona publike ka ndikuar negativisht në rezultatin e edukimit arsimor (learning outcomes) që në këtë vend të varfër europian të ekzsitojnë familje pa shtëpi,

pa strehimore, pa kulm në kokë, si me jetue në Afrikë apo në shkretirë, dhe masa intelektuale shqiptare sekulare dhe antifetare islame duke pritur ndihmë nga Europa, komuniteti internacional, duke harruar faktin dhe realitetin e hidhur historik të kohës moderne (shek.19 dhe 20) që Europa asnjherë nuk ka ndihmuar për kauzën shqiptare muslimane!! Turp !!

e.pasojat ekonomike: Kamata, kreditë e shumta me miliona euro, vështërsia e pagesës së kredisë me proviyone të mëdha ku e rrezikon konfiskimin e pasurisë së patundshme apo të paluhatur (shtëpisë, tokës, çdo gjë që posedon) nëse nuk ekzekutohet pagesa mujore e kredisë, pagat e vogla jo me standarde europiane, kapitalizmi dhe arritja në pasuri me metoda të skeptike, vërehet haptazi dhe qartazi dallimi klasor aristokrat/borgjez, si në periudhat e mesjetës shek. XIV në Europë, ku shihet populli shqiptar si bujkrobër te feudali, etj.

- **F. Pasojat politike:**

Politikanë të korruptuar shërbejnë për qarqe, organizata dhe qendra skeptike në disfavor të shtetit tonë, kolaborojnë me armikun, keqpërdorin pozitat e tyre qeveritare, nepotizmi, mashtrojnë, gënjejnë, zihen me kontrabanda dhe trafikim njerëzor ilegal, me shpëlarje parash në emër të organizatave jo reale (FALCO), bashkëpunim me policinë për qëllimet dhe interesat e tyre personale, etj etj.

08. CILI ËSHTË QËLLIMI I ZHVILLIMIT TË MEKTEBIT NËPËR XHAMIA DHE ÇKA PËRFITON SHOQËRIA ME ZHVILLIM TË MEKTEBIT?

Qëllimi nga mësim-besimi nëpër mektebe të xhamijve të Kosovës dhe gjetiu është ruajtja e identitetit fetar islam nga rreziku i asimilimit fetar, kulturor dhe moral. Shyqyr Allahut xh.sh. dhe të gjitha falënderimet i takojnë Atij për këtë dhunti dhe mirësi ndaj nesh, elhamdulillah që jemi Musliman dhe që na ka ruajtur Allahu xh.sh. prej kthetrave të regjimit komunist në ish-Jugosllavinë e Titos komuniste dhe aparaturës ortodokse fanatike serbo-sllave që nga koha e kriminelëve dhe kasapëve serbo-ortodoks: Car Dushani, Vaso Çubriloviçi, Slobodan Milosheviçi etj, gjer në këtë kohë. Këto mektebe/klasa/zyre/dhoma të vogla të bashkangjitura xhamisë, apo vetë xhamitë; kanë luajtur rol pozitiv të madh gjatë shekujve gjer më sot në mirëmbajtjen e besimit të Monoteizmit, të Teuhidit të pastër Islam, besimit në një Zot i Cili është i Vetëm, i Cili nuk ka lind askend – s’ka femije -, dhe vet nuk është i lindur nga dikush- nuk ka prind – dhe askujt nuk i përngjan dhe askush nuk i përngjan Atij, të Cilin e kanë besuar të parët tanë, dhe na e kanë trashëguar neve të pastër e të kulluar si loti i syrit. Ne të gjithë jemi borxhli ndaj tyre me lutje të pashkëputura gjer në vdekje. Po ashtu në këtë kontekst duhet falënderuar BIK-un e Kosovës për organizimin e këtyre klasave dhe ligjëratave të mësim-besimit nëpër mektebe që nga vitet e 50-ta të shek.20 gjer më sot. Allahu i shpërbleftë dhe i gradoftë me Xhenet.

Tani në këtë kontekst duhet shtruar nje pyetje e cila kërkon një përgjigje të madhe. Pyetja thot: A është i mjaftuar mësim-besimi fetar nëpër mektebe për ta sfiduar gjendjen globale dhe aktuale anti-islame anembanë globit e sidomos rasti i shqiptarëve? Përgjigjja është: JO, nuk është i mjaftuar dhe se ky mision që është duke u zhvilluar në mënyre rutine nuk është mjaftuese, dhe gjendja faktike dhe aktuale dëshmon për efektin e dobët dhe jo të mjaftueshëm në këtë kohë. Nëse para 50 viteve në kohën e ish-Jugosllavisë nuk kemi poseduar kushte të mjaftueshme për ta zgjeruar misionin edukativo-arsimor për ruajtjen e identitetit tonë fetar Islam, sot i posedojmë këto kushte dhe resurse humane, mediatike, shkencore, materiale etj, dhe se këto duhet të ripërdoren gjer në maksimum. Apeloj urgjentisht që misionin mektebeve ta transformojmë në misionin e shkollave fillore publike, të mesme, kolegje dhe universitete (fakultet dhe studime post diplomike). Është imperativ kur'anor dhe profetik që këto reforma të zhvillohen urgjentisht duke koordinuar me qeverinë dhe institucionet përkatëse dhe me qeveritarë e liderët politik, dhe se BIK-u të jetë i sigurt dhe më këmbëngulës, më guximtar dhe pa kompromis, ti sfidoj anti-islamistët, anti-fetarët publikisht, nëpër media, me debate direkt dhe live gjer të realizohet kjo ender e besimtarëve shqiptarë në Kosove dhe gjetiu. BIK-u e ka forcën shpirtërore dhe fizike të 95 % të popullatës së Kosovës, e aji forcë është: ISLAMI & MUSLIMANËT e KOSOVËS, dhe mos të harrojmë se në shtetet demokratike në Europës kjo kërkesë është realizuar që moti, sepse konsiderohet dhe është konsideruar e drejta humane bazike e njeriut, dhe mos të harrojmë Serbinë-

fqinje, se kjo reformë e edukimit fetar ashtë aktive dhe funksionale që sa vite në Bujanovc, Preshevë etj, dhe nuk e kuptoj pse pret BIK-u, dhe pse qeveria apo deputetët shqiptarë në parlamentin e Kosovës e anashkalojnë dhe e neglizhojnë këtë të drejtë të popullit !? Mjaft më!

09. SA NDIKUAN SFIDAT E TEKNOLOGJISË MODERNE NDAJ FAMILJES TRADICIONALE? SA ËSHTË NDIKIMI I TEKNOLOGJISË ELEKTRONIKE SIÇ JANË: TELEVIZORI, INTERNETI, RRJETET SOCIALE ETJ., DHE CILAT JANË PASOJAT SIPAS JUSH?

Sfidat e teknologjisë moderne kanë ndikuar dhe akoma vazhdojnë të ndikojnë negativisht gjer në maksimum, sa që nuk ka ngel asnjë vlerë morale apo parim njerëzor të shëndosh pa u infektuar dhe pa u deformuar, VE LA HAULE VE LA KUV-VETE IL-LA BIL-LAH ! (s'ka mundësi se si të dalet nga kjo gjendje vetëm me ndihmën e Allahut xh.sh). E tërë kjo pasojë me përmasat e saja (personale, familjare, morale, sociale, ekonomike, politike që i përmendëm). Këto pasoja dhe dëme –sipas analizave tona – janë si rezultat dhe pasojë e pasivitetit institucional shtetëror dhe atij fetar Islam dhe këtu në këtë kontekst e kam për qëllim pasivitetin dhe mos angazhimin maksimal të BIK-ut, nëpër xhamia, medrese dhe fakultetin tonë Islam të vetëm në Kosovë. Që të jemi ma konkret dhe për ta qartësuar këtë konkludoj: mjafton që të hedhim një shikim dhe një elaborim tematikave të ligjëratave të hoxhallarëve dhe imamëve tanë nëpër xhamiat tona, nje elaborim të përmbajtjes së lëndëve fetare dhe humane në kurikulat tona pedagogjike dhe fetare ku vërehet qartë se këto ligjërata dhe tematika, dhe këto kurikula nuk japin imunitet moral e as imunitet etik për t'i sfiduar këto ryma demagogjike dhe anti islame, këto tema dhe këto kurikula nuk ecin paralel me kërkesat dhe problemet bashkëkohore, dmth: nuk po kanë dobi

në tregun e jetës së muslimanit bashkëkohor, nuk po janë funksionale. Këtë e vërteton edhe gjendja e mjerueshme e shfrenuar morale dhe etike e popullit shqiptar musliman, ku krimet dhe veprat penale janë shokuere. Po ashtu edhe frytet e sistemit edukativo-arsimor human dhe social në përgjithësi dhe atyre islame në veçanti nuk janë për t'u krenuar! Të dobët në njohuri të përgjithshme fetare apo humane, sociale! Të dobët në inovacione shkencore biologjike, medicinale, mekanike, astronomike, etj,

Të dobët në kuptimin e gjuhës arabe, angleze, franceze (me përjashtime), nuk janë në gjendje me komunikim brenda 4 viteve që mësojnë lëndën e arabishtes në medrese, plus niveli universitar në fakultet 4 vite=totali 8 vite, të dobët në kuptimin dhe leximin e Kur'anit, lexim të shëndosh me rregulla (texhvid), të varfër në argumentimin dhe aplikimin e ajeteve kur'anore gjatë ligjëratave të tyre dhe në jetën e tyre, dalin prej tyre armiq më të mëdhenjtë të fesë Islame publikisht që janë edukuar në medrese (disa raste) e që e sulmojnë fenë Islme, Kur'anin, Muhamedin a.s., dijetarë Islam, janë lojal me anti Islamistat, me të krishterët, budistat, hebrenjtë, fyerje dhe ofendime ndaj arabëve dhe muslimanëve, etj etj.

E tërë kjo gjendje e lodhur dhe e rraskapitur morale dhe etike, shkencore dhe ekonomike e popullit në përgjithësi dhe të masës intelektuale në veçanti e ka rezultuar në dobësinë e familjes tradicionale islame para sfidat moderne të këtij shekulli. Dalja nga kjo krizë e lartë-përshkruar bëhet me korrigjime dhe reforma

fetare dhe shkencore të duhura institucionale, qeveritare duke i përmbushur kërkesat e jetës dhe të popullit me solucione të shëndosha nga barnatorja e kur'anit, të synetit të Muhamedi a.s., të dijetarëve dhe shkencëtarëve eminent botëror, nga tradita e civilizimit islam. E tërë kjo arrihet me punë dhe me programe dhe plane akademike e jo me fjalë dhe llafe të kota. Punë punë natë e ditë që të shohim pakës dritë. Allahu na mundësoftë ne, dhe liderët tanë për kontribut pozitiv në zhvillimin e shtetit dhe të popullit tonë. Amin

10. SA KA NDIKUAR JETESA MODERNE NDAJ FAMILJES TRADICIONALE SI PSH: MUNGESA PARAPRAKE E EDUKIMIT MARTESOR, BASHKËJETESA PA KURORË, BASHKËJETESA ME PRINDËRIT APO NË FAMILJE TË ZGJERUAR, ETJ., DHE CILAT JANË PASOJAT E SË ARDHMES SIPAS JUSH?

Koha moderne e shek.21, ka ndikuar negativisht me përmasa të mëdha që përmendëm më herët dhe akoma vazhdon të ketë impakt negativ në jetën tonë islame në përgjithësi, e ne familjen muslimane tradicionale në veçanti. Mos realizimi dhe mos aplikimi i parimeve dhe koncepteve islame të lartë përmendura (kurset edukativo-arsimore para martesore, kriteri i moralit dhe i fesë islame në përzehjen e bashkëshortit/bashkëshortes, riaktivizimi i institucioneve fetare, futja e lëndës fetare në shkollat fillore, të mesme, nivelit universitar, reformat e kërkuara në diskursin fetar aktual, integrimi i parimeve islame në jetën e përgjithshme, koordinim në mes BIK-ut dhe qeverisë sa i përket censurimit të mediave në talljen/fyerjen e religjioneve në përgjithësi dhe të islamit në veçanti etj etj.), e tërë kjo gjendje e mjeruar ka prodhuar në vendin tonë stile të reja europiane-amerikane, bashkëjetesë pa kurorë (kinse e fejaura/i fejuari)!! Ai /ajo thjesht (boy friend / girl friend), dalin bashkë, rrinë bashkë, qeshin bashkë, ndoshta edhe flenë dhe marrin tush bashkë, udhëtojnë bashkë !! Po na thonë se kinse po testojnë njeri tjetrin, nuk ban mu ngut, kemi disa plane tjera, martesë nuk është urgjente, pas 1/2/3/ vite ndoshta martohemi, ta përfundoj

fakultetin, të punësohem, jo me jetuar me prindërit, me planifikua për lindjen e 1 fëmije –apo edhe 1/2 (gjysmën e fëmijës), se jeta e shtrenjtë, ikje/shpërngulje në Evropë/Amerikë etj. etj., vaj halli për ne dhe për këtë popull.

Gjenerata dhe fëmijë të këtij lloji ka prodhuar kultura e sotme globale edukativo-arsimore e avancuar moderne!! që nuk njeh dhe nuk respekton parimet e fesë islame as tradicionale, që lufton traditat e mira muslimane të trashëguara, që kërkon jetë të shfrenuar dhe pa kufi, të rinjtë / të reja të degjeneruar moralisht dhe etikisht, konsumon ma shumë se sa prodhon, endacakë, përtac, lufton dhe debaton për të drejtat e (LGBT-ve) etj. etj, vaj halli për ne! vaj halli për shqiptarët muslimanë! vaj halli për ardhmërinë tonë nëse nuk shpejtojmë me reforma fetare, sociale, institucionale të duhura, do të na kaplon sherri dhe dënimi i madh shkakut i përhapjes së këtyre dukurive të këqija dhe shkakut i mos reagimit tonë për t'i shpëtuar ata duke i urdhëruar, duke i mësuar, duke i trajnuar kah e mira dhe duke i ndaluar dhe këshilluar nga e keqja që mos të zhyten në të ndaluar dhe çka është e keqe.

Besoj që isha i qartë në këto përgjigje, aktuale, fetare, akademike, sociale, kulturore, politike dhe ekonomike, dhe nëse ia kam qëlluar e falënderoj Allahun xh.sh. për këtë, e nëse jo, Atij i lutem për të ma falur gabimin, dhe Ai e di më mirë.

Në fund them: VE MA TEUFIKIJ IL-LA BIL-LAH THEMË -
MBARËVAJTËSINË - TIME & TUAJIN - VETËM NGA ALLAHU DUA
TA KEM...amin amin amin.

**Këto përgjigje i shkroi, disa herë i kontrollloi dhe i korrigjoi,
robi dhe i varfëri Allahut Fuqiplotë:**

Prof.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha,

Doha-Katar

23 Janar 2022

PJESA II

**PËRGJIGJE AKADEMIKE, FETARE,
EDUKATIVO ARSIMORE NGA
PROF.DR.HFZ HAJREDIN HOXHA
PËR PYETJET HULUMTUESE NGA
STUDENTËT KOSOVARË NË NIVEL
TË DOKTORATURËS NË
UNIVERSITETIN NDËRKOMBETAR
TË NOVI PAZARIT**

PËR PYETJET HULUMTUESE NGA STUDENTËT KOSOVARË NË NIVEL TË
DOKTORATURËS NË UNIVERSITETIN NDËRKOMBETAR TË NOVI PAZARIT

01. SI MENDONI PAS ADHURIMIT NDAJ ZOTIT A ËSHTË GJËJA MË ME VLERË KONCEPTI PEDAGOGJIK I NJERIUT (EDUKIM DHE ARSIMIM), DHE A MUND TË THEMI SE NJERIU PA EDUKIM PEDAGOGJIK ËSHTË I MANGËT NË ADHURIME NDAJ ZOTIT?

1. Të adhuruarit e Allahut xh.sh. (IBADETI NË KUPTIMIN UNIVERZAL, ASPEKTI TEORIK DHE AI PRAKTIK I PËRGJITHSHËM) është qëllimi dhe objektivi kryesor për të cilin njeriu është krijuar. Ky realitet është e cekur në Kur'an në suretu el Dharijat, ajeti 56 (*Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.*). Ky adhurim nuk plotësohet pa edukim dhe pa arsimim. Ky realitet është i potencuar në Kur'an në suretu Muhamed, ajeti 19 (*Atëherë, dije se nuk ka Zot tjetër pos Allahut, kërko falje për mëkatin tënd, për të besimtarëve e të besimtareve, All-llahu e di për lëshimet tuaja (për vepra) dhe për vendin tuaj*). Këtë realitet e ka theksuar edhe Imam Buhariu në Sahihun e tij, kur i ka ndarë hadithet e mbledhur në kapituj sipas tematikave, ku thotë:

(Sahihul Buhari, Kapitulli: DITURIA, EDUKIMI, ARSIMIMI PARA FJALËVE DHE VEPRËS).

Duke u bazuar në argumentet e lartpërmendura shihet qartazi se vlera e kërkimit të diturisë, arsimimit, edukimit është vepra, puna më e dashur te Allahu te Allahu xh.sh, pas besimit në Njësinë e

Tij-Teuhidin e Tij, dhe ata të cilët janë të edukuar, të arsimuar janë më të dashurit e Allahut xh.sh, dhe më të ngiturit në shkallët e Xhennetit. Kjo meritë është shënuar në Kur'an ku Allahut xh.sh. i ka veçuar, i ka dalluar dijetarët me ngritjen e shkallëve të tyre në Xhennet, thotë Allahu xh.sh. në Kur'an në suretu el Muxhadele, ajeti 11 (*...e Perëndia do t'i lartësojë besimtarët që janë prej jush, e veçanërisht dijetarët do t'i ngrisë në shkallë të lartë. E, Perëndia di çdo gjë që punoni*), po ashtu Allahu xh.sh. e vulos këtë realitet të vlerës së diturisë, shkencës, edukimit, arsimimit me vulën përfundimtare ku thotë në suretu ez Zumer, ajeti 9 (*Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Vetëm mentarët i pranojnë këshillat!*).

Në këtë kontekst ka dhjetëra hadithe tjera të transmetuara nga Muhamedi a.s, për vlerën e kërkimit të diturisë, arsimimit, shkencës me qëllim të njohjes së Allahut xh.sh., njohjes të këtij universi dhe krijesave tjera të cilët dëshmojnë për ekzistencën dhe Njësinë e Allahut xh.sh., por hapësira e këtij pyetësi nuk na premtun të zgjerohemi ma shumë.

Allahu na bëftë prej kërkuesve të sinqertë të diturisë, të arsimimit, të shkencës për ta kompletuar besimin tonë, për ta plotësuar ibadetin tonë, për t'i shërbyer popullit kudo që të jemi dhe kudo që të punojmë, dhe diçka nuk duhet harruar dhe duhet kujtuar gjithmonë: SE DITURIA, ARSIMIMI, EDUKIMI PA BESIM TË PASTËR NË ALLAHUN XH.SH, DHE PA FRIKËN E TIJ ËSHTË I PAMËSHIRSHËM DHE QON NË SHKATËRRIM TË NJERIUT DHE

NJERËZISË, Argument për këtë realitet i kemi ngjarjet historike të dhimbshme në kohën moderne të disa superfuqive botërore të cilët e kanë keqpërdorur diturinë dhe të ariturat e tyre shkencore, teknologjike dhe industriale duke i bombarduar, masakruar, djegur, shkatërruar njeriun dhe çdo gjë çka është njerëzore. Kemi rastin e bombardimit me bomba atomike të Hiroshimës dhe Nagazakit nga amerikanët, rastin e masakrave dhe gjenocidin amerikan në Vietnam, rastin e gjenocidit serb në Srebrenicë të Bosnjes dhe Prekaz e Raçak të Kosovës, rastin e Hitlerit nazist në dy luftërat botërore etj etj, rastin e Israelit në Gaza te Palestinës etj etj.

Allahu xh.sh, e di më mirë. *(me gjerësisht shih punimin tim: doracak me rëndësi për fillestarët në kërkimin e diturisë)*
www.drhafezi.net

02. SA KA NDIKUAR PEDAGOGJIA DHE CIVILIZIMI ISLAM NË PEDAGOGJINË DHE CIVILIZIMIN GLOBAL GJATË HISTORISË?

Duke u bazuar në argumente e lartpërmendura, muslimanët përgjatë historisë së tyre, gjatë sundimit dhe civilizimit islam i kanë dhënë shembull tërë njerëzimit me fjalë dhe vepra, teorikisht dhe praktikisht. Ky përkushtim i tyre ndaj kërkimit të diturisë dhe distribuimit të saj, me shkrime dhe vepra profesionale, enciklopedike rreth lëmive dhe disiplinave të ndryshme shkencore dhe humane është bazuar në dy shtylla apo procese filozofike:

1. procesi/procedura e përballjes me të tjerët, dhe
2. procesi i importit/marrjes/zënies së diturisë prej të tjerëve, dmth: marrëdhënie nga kulturat dhe shkencat tjera, me fjalë tjera, shartimi/gërshetimi i diturive.

Ky gërshetim , shartim nuk ka mjaftuar me kaq në historinë e zhvillimit shkencor dhe atij pedagogjik islam. Muslimanët kanë shpikur një metodologji të re shkencore dhe filozofike të paparë në historinë islame dhe atë njerëzore. Ato dituri dhe shkenca të përfituara nga civilizimet tjera (*greke, indiane, persiane, romake*) kanë filluar të lindin në kohën e Dinastisë Emevite me iniciativën e Princit Halid ibn Jezid ibn Muavije (*vdijq në vitin 84 Hixhri/702 Miladi*) i cili e ka dashur lëndën e kimisë shumë, dhe për këtë qëllim ka sugjeruar me lidh marrëdhënie pune me disa filozof

grek të cilët shkonin dhe punonin në Egjipt dhe të cilët e dinin arabishten bukur. Ai kërkoi nga ata që burimet dhe referencat e Kimisë në gjuhën greke dhe kibtiane të përkthehen në gjuhë arabe. Pas kësaj erdhi periudha zyrtare në kohën e Dinastisë Abasite gjatë kohës Ebu Xhafer el Mensur (*vdiq në vitin 158 Hixhri/775 Miladi*), kur qeveria mbretërore e tij filloi të mbikqyrë zyrtarisht këtë zhvillim dhe civilizim islam, sa që në kohën e mbretit filozof Abdullah el Ma'mun (*vdiq në vitin 218 Hixhri/833 Miladi*) ariti kulminacionin e zhvillimit shkencor dhe atij pedagogjik.

Muslimanët i dhanë zhvillim të madh dhe shtyrje të madhe dhe të pashembullt botës islame dhe asaj jo islame në fushën e Medicinës, Astronomisë, Matematikës, Kimisë, Filozofisë, Religjioneve, Përkthimin e shkencave filozofike greke, kibtiane, romake, indiane, syrijane –sirianic - në arabishte. A mjaftuan me kaq? Jo! Ata korrigjuan të gjitha konceptet e gabuara filozofike greke të Aristotelit e Platonit, treguan dobësitë e atyre shkencave humane dhe njerëzore, i rishkruan/ripërpiluan sërish këto shkencë, dhe vendosën kritere/peshoja islame (*Criteria of Center* - *شهادة لمرکز*) se çfarë duhet pranuar prej diturive dhe çfarë jo, (dmth: të pranohen shkencat të cilat nuk e kontradiktojnë Islamin (Kur'anin dhe Synetin) dhe çfarë duhet refuzuar (kontradiktojnë Islamin), dhe normal muslimanët i kanë pranuar ato diturit humane dhe shkencore të cilat nuk ndeshen me parimet Islame, e kanë përdorur metodën selekcionuese –siç e konfirmon

rahmetliu presidenti Alija Izet Begoviç - dhe nëse diçka ka hasur në ndeshje me Islamin ata e kanë riparuar atë defekt akaidologjik apo kulturor me fjalë tjera kanë bërë (*Islamizimin e Diturive - Islamization of Knowledge - بللإلهة للمعارف وللمحوم*). Këtë parim shkencor dhe fetar në kohën moderne e udhëheq Universiteti Ndërkombëtar Islamik në Kuala Lumpur (*International Islamic University- Malaysia IIUM*), aty bëhet integrimi dhe gërshetimi/shartimi i shkencave humane dhe atyre fetare islame (*të shpallura*), dhe se ky universitet duhet të jetë lider dhe shembull për kurikulat e tërë universiteteve islame në botë.

Muslimanët përgjatë civilizimit islam i kushtuan rëndësi të madhe edhe në zhvillimin e infrastrukturës (*urat, bunarët, kalatë, shtëpitë për pleq, spitalet, strehimoret -rabatet- për udhëtarët, ushqimoret, vakëfet*) e shumta dhe të llojllojshme. Beneficionet prej këtyre projekteve kanë qenë gratis dhe në shërbim të shoqërisë islame dhe asaj jo islame pa dallim. Këto realitete janë pamohueshme në historinë dhe civilizimin tonë islam. I tërë ky zhvillim ka ec paralel me besimin e tyre të pastër dhe me zhvillimin e pedagogjisë, edukimit dhe arsimimit islam. Allahu i shpërbleftë me Xhennet, amin amin amin.

03. CILAT JANË ATO CILËSITË DALLUESE TË SJELLJES SË PEJGAMBERIT A.S., QË CILËSOHET NGA ZOTI XH.SH., SI KRIJESË ME VIRTYTE MË TË LARTA PEDAGOGJIKE?

Allahu xh.sh. e ka cilësuar Muhamedin a.s. me shkallën më të lartë moralit. Thotë Allahu xh.sh. në suretu el Kalem, ajeti 4: *(Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali!)*. Me këtë lëvdatë Allahu xh.sh, na bën me dije se ky peygamber është më i edukuari dhe më i arsimuari i përzgjedhur nga Allahu xh.sh. për udhëzimin e njerëzimit. Në këtë kontekst po përmendim disa cilësi dalluese të sjelljes së Muhamedit a.s., e prej tyre veçojmë:

a-nuk ngutej gjatë fjalimit, **b**-e përsëriste disa herë mesazhin/fjalinë, **c**-nuk e ngrite zërin, **d**-ishte mësuesi më i dashur për të gjithë, për besimtarë dhe jo-besimtarë, **e**-i dëgjonte të moshuarit dhe të rinjtë kur flisnin, **f**-nuk e ndërpriste askë gjatë të folurit, **g**-nuk kritikonte në mënyre direkte dhe nuk përmendte emra të personave të kritikuar, edhe pse i dinte se kush janë ata, por e bënte këtë në mënyrë indirekte për ruajtjen e paqes dhe të dinjitetit të njeriut, **h**-nuk e rëndonte askënd me fjalë të rënda, **i**-i butë dhe i sjellshëm me të gjithë (*Munafikët, Hebrenjtë, të Krishterët, Arabët jo besimtarë (paganët/mushrikët)* prej fiseve të ndryshme etj etj.

Këto veti pedagogjike, etike dhe morale që ishte pajisur Muhamedi a.s. – e që duhet pajisur çdo musliman dhe çdo besimtar e në radhë të parë hoxhallarët, profesorët, arsimtarët, mësuesit, edukatorët në foshnjore, prindërit dhe çdo lider a person që është në pozitë) janë të dëshmuara me ajete kur’anore dhe hadithe të Muhamedit a.s. dhe se shkak i hapësirës së ngushtë po i përmendim ca prej tyre. Thotë Allahu xh.sh. në suretu el Enfal, ajeti 159 (*Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj t'i falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se All-llahu i do ata që mbështeten*). Po ashtu edhe në Sahihun e Imam Buhariut transmetohet rasti i atij Earabiut/Bedunit /fshatarit i cili ka urinuar në Xhami të peygamberit a.s. në prezencën e Muhamedit a.s. dhe të sahabeve! Disa prej sahabeve deshën ta ndalin me forcë, por peygamberi a.s. iu tha: jo ! mos e ndalni urinimin e tij! Merrni një kovë me ujë dhe derdheni në atë vend ku ka urinuar në mënyrë që të shpërlahet dhe të pastrohet vendi. Në këtë rast Muhamedi a.s. iu tha: Allahu kërkon lehtësim dhe jo vështirësi, ju ka dërguar që të lehtësoni dhe jo ta vështirësoni, pastaj Muhamedi a.s. ma vonë e thërret Earabiun/Bediunin dhe i thotë në mënyrë të butë: a nuk je Musliman a? Ai tha po, pastaj Muhamedi a.s. shtoi duke thënë se këto vende dmth: xhamia, faltoret janë për Ibadet dhe për Dhikr, nuk bën diçka të ndytë me pas në këto vende të shenjta. Dhe në këtë rast shihet qartë butësia

pedagogjike e Muhamedit a.s. gjatë edukimit, arsimimit, këshillimit dhe udhëzimit të tjerëve. Allahu na mundësoftë që të edukohemi me këtë edukatë të lartë islame (kur'anore dhe profetike) kudo që të jemi dhe më këndo jemi. Amin, amin, amin.

04. SA KA NDIKUAR PEDAGOGJIA E PEJGAMBERIT A.S., NË EDUKIMIN NJERËZORË GJATË HISTORISË?

Kjo pedagogji profetike e Muhamedit a.s. e shpallur nga Allahu xh.sh, me të cilën është pajisur personaliteti i Muhamedit a.s., dhe e cila është demonstruar në fjalët, gjendjen dhe veprat e tij, në jetën e përditshme me shokët e tij dhe të tjerët. Po si të mos ketë ndikim pozitiv pedagogjia e Muhamedit a.s. kur Allahu ka deklaruar në librin e Tij në suretu el Ahzab, ajeti 21 (*Ju, me të vërtetë, Pejgamberin e Perëndisë e keni shembull të mrekullueshëm, për atë që i druan Perëndisë dhe Ditës së Kijametit, dhe i cili e përmend shumë Perëndinë*). Po ashtu transmetohet nga Muhamedi a.s. se ai një ditë i ka pyetur shokët: *A dëshironi të dini se Xhehenemi për kënd është haram (kënd e ka të ndaluar me djegë)? Xhehenemi është haram për çdo musliman i cili është i lehtë, i butë, i mëshirshëm, i afrueshëm*. Me këto veti morale janë pajisur edhe shokët e tij përgjatë predikimit të islamit anëmbanë botës. Ata me sjellje të mira, me sinqeritet, me besnikëri, besueshmëri, korrektësi në marrdhënie tregtare e kane përhapur islamin në viset e largëta të Azisë-Juglindore në Malajzi, Indonezi, Filipine etj. Po ashtu edhe në shekujt e kohës moderne duke filluar nga shek. 17 -21 kemi shumë raste që prej faktorëve kryesore që i ka shtyrë popujt në mënyrë masive apo individuale për pranimin e Islamit ka qenë, dhe është sjellja personale sociale e mirë, e sinqertë e muslimanëve me të

tjerët gjatë tregtisë, jetës së përgjithshme ku kemi qindra raste të evidentuara rreth kësaj çështje. Ky realitet i pedagogjisë islame ka qenë prezentë gjithmonë në këshillat dhe udhëzimet e Muhamedit a.s. me shokët e tij kur i ka dërguar nëpër vende të ndryshme për ta predikuar islamin.

Transmeton Imam Buhariu nga hadithi i Ebu Hurejrës rastin e Ebu Musa el Esh'ariut dhe Muadh ibni Xhebelit kur i ka dërguar në Jemen dhe ju ka thënë: *keni kujdes! Përgëzoni njerëzit, jepuni myzhde dhe assesi mos i largoni me fjalë apo me punë, lehtësoni dhe mos vështirësoni, pajtohuni, ujdisoni mes vete dhe mos u kundërshtoni.*

Mos aplikimi i pedagogjisë islame nëpër institucionet tona edukativo- arsimore fetare, apo nëpër shkollat shtetërore të të gjitha niveleve të edukimit, ka ndikuar negativisht në kokën, zemrën dhe sjelljet e nxënësit apo studentit. Hasim në mësues, arsimtarë, edukatore në foshnjore ku e përdorin forcën/ dajakun/ thupren/ shuplaken!! Kjo metodologji pedagogjike në edukim ka sjellë gjendjen tonë në atë fazë ku dhuna familjare, sociale, bashkëshortore është në rritje të dukshme.

Si të dilet nga kjo gjendje e mjerueshme?

Përgjigjja është e thjeshtë dhe e qartë! Aplikimi i pedagogjisë islame në edukim dhe arsimim, duke përfitur edhe prej metodave të tjera pedagogjike moderne të cilat nuk ndeshen me parimet e Islamit në besim dhe në moral, e sidomos në këtë

kontekst rekomandoj fuqishëm të përfitojmë nga sistemi pedagogjik edukativo arsimor japonez dhe malajzian. Për me gjerësisht rreth këtij qëllimi referoju punimeve tona: **1-** (*Edukata/pedagogjia e mësuesit dhe studiuesit të Kur'anit*), **2-** (*Mungesa e Precizitetit në Edukim dhe Arsimim- studim komparativ të edukimit japonez-amerikan-arab*), **3-** (*Malajzia një rrëfim i suksesshëm i edukimit bashkëkohorë*) në webfaqen tonë: www.drhafezi.net.

05. CILI ËSHTË QËLLIMI I EDUKIMIT DHE ARSIMIMIT TË SHOQËRISË, DHE A KA PERSPEKTIVËN E SË ARDHMES NJË SHOQËRI PA EDUKATE TË MIRËFILLTË DHE ARSIMIM CILËSORË?

S'do mend se qëllimi nga edukimi dhe arsimimi i shoqërisë në përgjithësi, dhe asaj islame/muslimane në veçanti është të përfitojnë dituri dhe shkenca të shëndosha humane dhe sociale. Këto dituri apo shkenca humane dhe sociale nuk mësohen për hir të shkencave si shkenca absolute, si shkenca të thata pa shpirt, pa qëllim të përfitimit prej tyre. Ato duhet të mësohen, të kapen për hir të përfitimit prej tyre në shërbim të shoqërisë njerëzore dhe nevojave humane, si psh: *medicina, inxhinieria, kimia, fizika, astronomia, matematika* etj. Çdo shkencë e cila del prej këtyre binareve dhe objektivave të pastra shndërrohet në armë dhe vegël destruktive të vet personit e pastaj edhe të shoqërisë. Sot në kohën moderne dhe globale, në aspektet kulturore dhe edukativo-arsimore shohim se këto shkenca kanë filluar të dalin prej objektivave të tyre të pastra për shërbim të shoqërisë. Sot nuk kemi arsimim të mirëfilltë dhe cilësorë shkakut i futjes së materializmit financiar, ku sheh shumë kolegje, akademi, fakultete po edhe universitete private të cilat nuk i përmbushin kriteret akademike në programet dhe kurikulat e tyre për akreditim, edukim akademik të mirëfilltë. Edhe cilësia e arsimimit edukativ në këto institucione nuk është në nivelin e

duhur, sepse stafi punues nuk është kualitativ dhe cilësor! Jemi të informuar për marrjen e diplomave Ma & Ph.D online!! Paguhen X & Y persona për shkrimin dhe artikulin e temave dhe disertacioneve të tyre! Jemi të informuar se në këto institucione private dhe jo cilësore nuk guxon asnjë staf/profesor me e ngel në provim ndonjë student të tyre, edhe pse e meriton ngeljen!! Sepse humbin një myshteri i cili ka paguar kaq euro (...)! etj.

Për t'iu shmangur këtyre defekteve edukativo-arsimore, për me pas arsimim kualitativ të shëndosh, për me pas kuadro të shëndosha dhe cilësore neve duhet së pari të kuptojmë se edukimi, arsimimi është EMANET & MISION i shenjtë, dhe se kjo shenjtëri përforcohet dhe e kryen punën me sukses kur mishërohen, integrohen parimet islame kur'anore me këto shkenca humane dhe sociale. Me fjalë tjera stafi akademik në krye me dekanin duhet të dinë dhe te mësojnë çka është hallall dhe çka është haram, çka është legale dhe çka është ilegale në sy të Islamit (Kur'anit dhe Syneetit), dhe në sy të ligjit. Nuk ka vend korrupsioni në edukim dhe arsimim, nuk ka hatër, nuk ka frikë nga ngelja e atij kandidati që nuk meriton ta kaloj klasën. Duhet kuptuar se emaneti i edukimit dhe arsimimit është i rëndë dhe jemi përgjegjësi-dhënës para Allahut xh.sh. dhe para organeve zyrtare/shtetërore. Cilësia e dobët në edukim është bërë epidemi globale, si në Amerikë, Europë dhe Arabi ! Normal me përjashtime.

Nëse i përfilllemi këtyre konditave islame dhe ligjore strikte, dhe ecim me këto parime të shëndosha fetare, akademike dhe ligjore; ne përgatisim kuadro politike, ekonomike, akademike, sociale, fetare të shëndosha dhe cilësore të cilat kontribuojnë **për një ardhmëri të shëndoshe në çdo fushë**. Në këtë drejtim dhe në këtë kontekst mund të përmendim si pionierë, liderë bashkëkohorë në fushën edukativo arsimore si në rastin e Universitetit Internacional Islamik në Kuala Lumpur, në Malajzi në krye me kryeministrin Dr.Mahatir Muhamed. Preferohet urgjentisht të lidhen marrëdhënie edukative arsimore dhe akademike me institucionet fetare dhe akademike me famë botërore me qëllim të përfitimit prej eksperiencës dhe lidërshiptit të tyre akademik, ku integrohen shkencat Humane, Njerëzore, Fetare Islame, dhe ato që kanë ndikuar pozitivisht dhe dukshëm në avancimin teknologjik, ekonomik dhe industrial në Malajzi. Në këtë kontekst mos të harrojmë edhe lidërshiptin akademik, teknologjik dhe industrial të Turqisë moderne në krye me Presidentin Rexhep Tajib Erdogan. Allahu mundësoftë që ta kuptojnë këtë realitet muslimanët në Ballkan, dhe elhamdulillah kanë filluar ta japin frytin e tyre siç është rasti me Universitetin Internacional në Novi Pazar, në Universitetin Internacional në Sarajevë, shkollat e Maarif të Turqisë. Dhashtë Allahu që edhe ne në Kosove të ndjekim rrugën e tyre cilësore akademike. Amin amin amin.

06. A MUND TË THEMI SE EDUKIMI PEDAGOGJIKO-FETAR ËSHTË I PRAPAMBETUR SIÇ DEKLAROJNË DISA MODERNISTË, DHE ÇFARË JANË DOBITË E EDUKIMIT FETAR?

Edukimi pedagogjiko-fetar në esencën dhe përmbajtjen e tij nuk është i prapambetur siç mendojnë dhe si pretendojnë modernistët apo sekularistët bashkëkohorë. Përkundrazi aty qëndron suksesi, energjia pozitive dhe sekretet e përparimit të individit dhe pastaj i shoqërisë, sepse po të ishte edukimi pedagogjiko fetar prezent në kurrikulat dhe tekstet shkollore dhe ato universitare; kjo do konsiderohej IBADET, (ME ATË KUPTIM TË GJERË UNIVERZAL QË PËRFSHIN TË GJITHA FUSHAT E JETËS) , si çdo lloj ibadeti tjetër që robi/muslimani afrohet tek Allahu xh.sh. Përderisa sistemet tona pedagogjike janë të zhveshura prej petkut fetar islam, kjo situatë e mjerueshme etike, morale, profesionale, akademike është një prej pasojave të saja. Po të integrohen tekstet shkollore dhe ato universitare me edukim fetar islam, me vizion të qartë dhe mision të shenjtë e të sigurtë sot nuk kishim hasur në luftë të hapur prej anti-islamistëve, sekularëve, të cilët e shikojnë edukimin dhe pedagogjinë islame me sy të mesjetës dhe inkuizicionit spanjoll të krishterë, të prishur dhe të korruptuar. Mjerisht intelektualët tanë kanë këso mendime të errëta për edukimin dhe pedagogjinë islame. Atyre iu është helmuar koka dhe gjaku prej gënjeshtreve dhe gënjeshtarëve sekular modern! Është turp për ta me konsideru

dhe me krahasu Islamin me parimet e religjioneve të korrumpuara (*hebreje, krishtere, hinduse, budiste*) etj. Intelektualet tanë modern nuk po janë në gjendje me bë dallimin në mes religjioneve pozitive të kurdisura dhe të shpikura nga mendja e njeriut, dhe në mes asaj që është e shpallur hyjnore dhe e pa korrumpuar siç është Islami. Sot, edhe gjatë shekujve të hershëm bota globale është ngritur dhe i kanë përgatitur dhe organizuar tërë forcat dhe ushtritë e tyre anti-islame, kundër islamit, që nga koha e kryqëzatave perëndimore që nga shek.11, e pastaj më vonë shek.13-14 në periudhën e inkuizicionit nëpër-mjet orientalistëve perëndimore dhe lindorë, nëpër-mjet misionarëve krishterë, nëpër mjet imperializmit ekonomik dhe atij politik, invadimit ushtarak të vendeve dhe trojeve islame/myslimanë. Historia na flet që perëndimi dhe aleatet perëndimorë në krye me Anglinë dhe Francën nuk kanë lënë vend pa e okupuar/invaduar, pa e shkatërruar infrastrukturën e atij vendi, pa e keqpërdorur dhe shkatërruar resurset natyrore dhe njerëzore, siç kanë bërë në Algjeri, në shumë vende afrikane etj. Kanë vjedhur dhe plaçkitur referencat e civilizimit islam dhe atij shkencor, medicinal, matematikor, astronomik etj. Kjo fushatë e egër shekullore anti-islame vazhdon edhe sot e kësaj dite me ngjyra dhe emra të ndryshëm anti-islam të shpikur si: lufta kundër terrorit dhe terroristëve (për qëllim e kanë islamin dhe myslimanët), islamofobia, orientalizmi perëndimor dhe qasjet e tyre ndaj burimeve islame nëpër fakultete islame në botën arabe dhe në perëndim, qendra të ndryshme ndërkombëtare për dialog ndër-

fetar, qendra afrikano lindore për studime orientale etj. Këtë rol të dyshimte po e luajnë edhe ambasadat dhe konsullatat ndërkombëtare me atashetë e tyre kulturorë përfshi ato iraniane, japoneze, amerikane, koreane, franceze, angleze, gjermane etj. Me ardhjen e regjimeve dhe ideologjive komuniste në trojet tona ballkanike këto fushata janë përforcuar dhe janë avancuar në disfavor të Islamit dhe të Myslimanëve. Kjo gjendje globale anti-islame e organizuar nga koalicionet perëndimore dhe ato me ideologji marksiste leniniste komuniste kanë prodhuar këso gjenerata intelektualësh të helmuar në kokë dhe në gjak me viruset dhe bakteret anti-islame. Ky është diagnozim i gjendjes.

E tërë kjo largohet dhe sfidohet me pedagogjinë edukativo arsimore fetare islame, me programe dhe kurikula të reja e të reformuara me vizion dhe mision të ri modern, me tekste shkollore të përgatitura nga ekspertët dhe akademikët që janë objektivë, duke e rishkruar dhe rianalizuar serish historinë shqiptare, boshnjake, turke prej fillimit pa falsifikime. Për këto çështje referojuni disertacionit tim të Doktoratës (DOKTRINAT E TEFSIRIT NË TROJET BALLKANIKE), Kapitulli i parë, 100 faqet e para, po ashtu shih veprën time (VËSHTRIM ISLAM RRETH FAKTORIT FETAR TË NEGLIZHUR NË HISTORINË SHQIPTARE MODERNE DHE ANTIKE), www.drhafezi.net, ku aty janë përmendur detale dhe fakte bindëse rreth temës në fjalë.

Me këto reformacione serioze akademike fetare ne mundemi me i sfidua modernistët ateistë apo sekularët bashkëkohorë, dhe me

i bind ata që edukimi dhe pedagogjia fetare islame nuk janë të prapambetura. Por ato janë larguar, neglizhuar dhe anashkaluar qëllimisht nga përpiluesit e teksteve shkollore që janë të përgatitura nga ekspertët rus, bullgarë, grek dhe serb. Allahu na ndihmoftë arritjen e këtij qëllimi të shenjtë duke i bashkuar forcat tona intelektuale akademike dhe fetare për t'i shërbyer shoqërisë sonë myslimanë dhe më gjerë, Amin, amin amin.

07. SA ËSHTË ME VLERË EDUKIMI I SHPIRTIT DHE TË ZEMRËS, DHE SA DUHET PËRKUSHTUAR VËMENDJEN NË KËTË GJË?

Pasojat e kësaj mungese të pedagogjisë fetare islame, e që sipas mendimit tonë është edhe mungesë *shpirtërore, morale, edukativo-arsimore, akademike, sociale, ekonomike dhe politike* janë të shumta dhe me përmasa të mëdha që vërehen publikisht dhe qartë pa koment. Në pikat që vijojnë po i përmendim radhazi disa shembuj të këtyre pasojave të lartpërmendura:

a-pasojat shpirtërore: vërehet qartazi mungesa e mëshirës/rahmetit, respektit në aspektin social, familjar dhe human në përgjithësi, s'ka dhimbje për njeri tjetrin, s'ka dashuri, s'ka sinqeritet, s'ka rahmet, s'ka interesim shpirtëror as solidaritet financiar te mjaftueshëm – me përjashtime te vogla-, që këto vlera burojnë nga zemra e Muslimanit dhe frika e tij nga Allahu xh.sh. Kjo frikë demonstron gjatë transaksioneve komerciale të ndryshme, në shitblerje, në marrëdhënie reciproke të ndërsjella, etj. Situata aktuale dëshmon jo në favorin tonë, dhe për fat të keq jemi tjetërsuar dhe jemi shndërruar në shoqëri materialiste, egoiste, kapitaliste ku interesit personal i jepet prioritet para interesit kolektiv etj.

b-pasojat morale: degjenerimi dhe asimilimi moral dhe karakter i rinisë sonë, narkomania, vrasjet, abuzimet familjare dhe

bashkëshortore, rastet shokuese të vrasjeve familjare, neglizhenca e kujdesit ndaj familjes dhe prindërve të moshuar ku vërehet kërkesa për shtëpi të pleqve, strehimore, qendra rehabilituese, prostitucioni, homoseksualizmi, feminizmi, stili perëndimor dhe amerikan në veshmbathje, në ushqim, në të folur, kulturat e huaja të përditshme në të folur, në ofendime, në sharje etj.

c-pasoja edukativo-arsimore: sekularizmi global dhe ai lokal, ofendimet ndaj Islamit dhe të muslimanëve (kjo dukuri vërehet qartazi, a ndërsa sulmi ndaj religjioneve tjera nuk vërehet fare dhe mediat dhe rrjetet sociale nuk i marrin si tema diskutimi), etiketimi i Islamit dhe i Muslimanëve me terrorizëm, vërehet qartazi dukuri skeptike dhe të dyshimta gjatë bizneseve si p.sh. kohëve të fundit në Kosovë të angazhuarit me fenomenin "BITCOIN" dhe përdorimin e rrymës ilegalisht, shpëlarje parash, transaksionet private me "PARA ME FAJDE", "BLERJA DHE SHITJA E DIPLOMAVE " të niveleve të ndryshme akademike, pastaj edhe punësimi në sajë të atyre kualifikimeve ilegale dhe të korruptuara. Po ashtu vërehet dobësia e kualitetit arsimor dhe shkencor: sheh rininë, të rinjtë dhe të rejtat janë fakultete (shkenca sociale apo humane) dhe nuk dinë për zanatin dhe profesionin e tyre po thuajse asgjë!! Shumë rrallë janë ata të cilët janë të kualifikuar dhe të arsimuar në profesionin e tyre, etj. Ma shkurt situatë mjerueshme dhe tmerr!!

d-pasoja sociale: dobësia e solidaritetit vëllazëror, varfëria e madhe, papunësia e madhe, gjendja ekonomike dhe financiare e

qindra familjeve është mjerueshme dhe prekëse në zemër!! Shihni p.sh. rastet e familjeve pothuajse të paralizuara dhe të vdekura nga uria dhe veshmbathja në emisionet: JETIMAT E BALLKANIT, ku vërehet kjo pasojë e solidaritetit. Muslimanët dhe biznesmenët shqiptarë në Kosovë dhe gjetiu pjesa dërmuese nuk dinë pothuajse asgjë për obligimin fetar 2.5 % të ZEKATIT, dhe kjo pasojë ka ndikuar që në këtë vend të varfër evropian të ekzistojnë familje pa shtëpi, pa strehimore, pa kulm mbi kokë, si me jetu në Afrikë!!

e-pasojat ekonomike: Kamata, kreditë e shumta me miliona euro, vështirësia e pagesës së kredisë ku e rrezikohet konfiskimi i pasurisë së patundshme apo të paluajtshme nëse nuk ekzekutohet pagesa mujore e kredisë, pagat e vogla jo me standarde evropiane, kapitalizmi dhe arritja në pasuri me metoda skeptike, vërehet haptazi dhe qartazi dallimi klasor aristokrat dhe atij borgjez, si në periudhat e mesjetës shek. XIV në Evropë, etj.

f-pasojat politike: politikanë të korruptuar u shërbejnë qarqeve dhe qendrave skeptike dhe janë në disfavor të shtetit tonë. Kolaborojnë me armikun, keqpërdorin pozitat e tyre qeveritare, mashtrojnë, gënjejnë, zihen me kontrabanda në bashkëpunim me policinë për qëllimet dhe interesat e tyre personale, etj.

8. A ËSHTË PËRMIRËSUAR ROLI DHE POZITA E GRUAS NË FAMILJE DHE NË SHOQËRI NË KËTË KOHË BASHKËKOHORE NË BOTËN ARABE?

Pasi qe Allahu xh.sh. na ka mundësuar të edukohemi në botën arabe dhe Azinë Juglindore dhe t'i shërbejmë Islamit dhe muslimanëve po në ato vende (el Medinetu el Muneweretu, Arabia Saudite, Doha –Katar, Kuala Lumpur – Malajzi, Brunei) afër 4 dekada që nga viti 1983 -2022, dhe pasi që kemi pasur kontakte të afërta direkt me popullin dhe studentët (meshkuj dhe femra nëpër fakultete të ndryshme), pasi që kemi marrë pjese në dhjetëra seminare dhe konferenca ndërkombëtare dhe rajonale, konkludoj lirshëm se pozita e gruas (nënë/ bashkëshorte/ vajzë) në familje nuk është përmirësuar dukshëm, shkak i disa traditave fisnore/kabelizmi të trashëguara prej të parëve, ku akoma gruaja/ vajza/ nëna nuk i gëzon të drejtat e saja të plota kur është në pyetje martesë, ku në të shumtën e rasteve nuk i lejohet asaj të dale jashtë fisit të saj !! Patjetër duhet të martohet me djalin e xhaxhait/axhës, apo të dajës, apo të tezes, apo të hallës. Kjo traditë akoma vazhdon dhe është në funksion dhe aktive për mashkullin dhe femrën. Kjo dukuri e trashëguar fisnore në shume vende arabe nuk ka të bëjë me islamin asgjë dhe nuk ka dy lidhje me te! Dëshira dhe vullneti i gruas /vajzës /djalit /

burrit duhet të respektohet dhe të merret në konsideratë mendimi Islam e jo ai tradicional, dhe se fjala e saj/ tij është finale dhe assesi tradita fisnore. Kjo dukuri sociale negative ka krijuar dhe është duke krijuar akoma pasoja të mëdha, ku statistikat flasin se mbi 40 % të shoqërisë në boten arabe janë të divorcuar, gjë që është e dhimbshme dhe shumë e rënde, sidomos në shtetet e Gjirit Persik (Arabia Saudite, Katari, Kuvajti, Bahrejni, Omani, Emiratet e Bashkuara). D.m.th. në këtë aspekt nuk ka ndryshim apo përmirësim.

A ndërsa nga aspekti i pozitës së saj në shoqëri, ka përmirësim (evolucion, reforma) të dukshme bashkëkohore, mirëpo unë nuk jam i kënaqur dhe nuk pajtoj me këtë përmirësim/liberalizëm të shfrenuar për pasojat negative që ka.

Është një stuhi e madhe globale kulturore dhe fetare që po vërshon botën arabe, sidomos Egjiptin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabinë Saudite, Bahrejnin, ku për qellim kanë prishjen femrës myslimane në emër të liberalizimit të saj, emancipimit të saj, shkollimit të saj/edukimit të saj etj. Kjo stuhi ka marrë përmasa të mëdha deri në atë shkallë sa që obligimet primare familjare, obligimet e saj ndaj burrit, të edukimit të fëmijëve neglizhohen dhe lihen anash. Për edukimin e fëmijëve mbështeten në shërbimin e shërbëtove nga Filipinet, S'ri Lanka, India, Etiopia etj. Kjo gjendje e ka keqësuar performancën e fëmijëve në aspektin edukativo arsimor, ku vërehen pasoja morale dhe edukativo arsimore si fryt i neglizhencës familjare. Kjo gjendje

aktuale sociale e shfrenuar në emër të globalizmit dhe të emancipimit të saj ka krijuar një gjendje të rëndë psikike, sociale, fetare dhe arsimore. Kjo diagnozë nuk na përgëzon për një të ardhme më të mirë. Ndikimi i kulturës perëndimore në çdo fushë (në stil të jetës, në të ushqyerit, në të folurit etj.) është dukshëm, e sidomos edhe me fenomenin modern që është absurde dhe vështirë për të besuar..! Je ne Arabi, por arabishtja nuk preferohet shume!! Anglishtja është ajo e cila preferohet. Kjo valë perëndimore asimiluese, shkatërruese edukativ-arsimore, kulturore dhe fetare sistematikisht është kah e shkatërron identitetin fetare dhe kulturor të saj, për fat të keq. Institucionet kulturore, fetare dhe akademike nuk janë duke punuar mjaft dhe seriozisht në këtë drejtim për t'i bërë ballë dhe për ta sfiduar këtë stuhi shkatërruese.

Perëndimi dhe kultura globale anti-islame me këto luftëra ideologjike fetare , akademike dhe kulturore e menaxhuar dhe e planifikuar prej Masonëve ndërkombëtarë në koordinim me Sionizmin dhe konspiracionin e tyre shekullorë kundër Islamit dhe muslimanëve, kanë arritur edhe në botën arabe dhe janë duke i kontrolluar qendrat mediatike, akademike dhe fetare. Si pasojë kësaj në Arabinë Saudite qindra dijetare, profesorë, hoxhallarë, aktivistë islam janë të burgosur, dhe shumë prej tyre edhe janë ekzekutuar, ku ndër ta edhe 2 profesorë doktorë, profesorë të mi. Në Egjipt regjimi ushtarak diktatorial mbyti presidentin e zgjedhur në mënyre demokratike Muhamed

Mursiun, burgosi dhe mbyti qindra dijetarë, Allahu në Xhennet in sha Allah. Frytet e Revolucionit të Pranverës Arabe nuk i priten Muslimanët dhe arabet e atyre shteteve, si në Tunizi, Libi, Egjipt, Siri, Jemen, Algjeri, etj. Ata i shfrytëzoi dikush tjetër në emër të Demokracisë! Anti-islamistët, sekularët, ateistët në krye me Masonerinë Globale Sioniste ishin ata që i shfrytëzuan.

Për momentin aktual me këtë gjendje dramatike në botën arabe nuk pritet diçka e mirë për Islamin dhe Muslimanët. Sipas analizave tona ne shpresojnë se valët e reformave pozitive për të mirën e Islamit dhe të muslimanëve anembanë globit priten nga Turqia, Pakistani, Afganistani, Malajzia dhe Indonezia. Allahu i ndihmoftë të gjithë të sinqertëve që synojnë të mirën e Islamit dhe të muslimanëve. Amin, amin, amin!

9. A MUND TË NA THONI SA ËSHTË ROLI I BASHKËSISË ISLAME NË EDUKIMIN E SHOQËRISË KOSOVARE, ME ANË TË INSTITUCIONEVE TË SAJA SI MEKTEBET, MEDRESETË, FAKULTETI, SHKOLLAT E KURANIT E BIBLIOTEKAT, DHE ME ANË TË PUBLIKIMEVE SIÇ JANË EDUKATA ISLAME, DITURIA ISLAME, TAKVIMI, ETJ.

Koha moderne e shek.21 & 22, ka ndikuar negativisht me përmasa të mëdha dhe akoma vazhdon të ketë impakt negativ në jetën tonë islame në përgjithësi, si në familjen myslimane ashtu edhe në aspektin edukativo-arsimor. Mos realizimi dhe mos aplikimi i parimeve dhe koncepteve islame (*kurset edukativo-arsimore para martesore, kriteri i moralit dhe i fesë islame në përzgjedhjen e bashkëshortit / bashkëshortes, riaktivizimi i institucioneve fetare, futja e lëndës fetare në shkollat fillore, të mesme, ato të nivelit universitar, reformat e kërkuara në diskursin fetar aktual, integrimi i parimeve islame në jetën e përgjithshme, koordinim në mes BIK-ut dhe qeverisë sa i përket censurimit të mediave në talljen/fyerjen e religjioneve në përgjithësi dhe të islamit në veçanti etj. etj.*), e tërë kjo gjendje e mjeruar ka prodhuar në vendin tonë stile të reja evropiane-amerikane, bashkëjetesë ne mes dy qifteve pa kurorë (kinse e fejuara/i fejuari)!! Ai / ajo thjesht (boyfriend / girlfriend), dalin bashkë, rrinë bashkë, qeshin bashkë, ndoshta edhe flenë dhe marrin tush bashkë, udhëtojnë bashkë, po e testojmë njeri tjetrin

duke thanë nuk bën mu ngut, kemi disa plane tjera ma me rëndësi, martesë ligjore/ fetare nuk është urgjente, pas 1/2/3/ vite ndoshta martohemi, ta përfundoj fakultetin, jo nuk dua të jetoj me prindërit, dua ta planifikoj lindjen e 1 fëmije, sepse jeta e shtrenjtë dhe harxhime të shumta, ikje/ shpërngulje në Evropë/ Amerikë etj. etj.

Gjenerata të këtij lloji ka prodhuar kultura e sotme globale që nuk njeh dhe nuk respekton parimet e fesë islame, që lufton traditat e mira myslimane të trashëguara, që kërkon jetë të shfrenuar dhe pa kufi, të rinjtë/të rejtat janë të degjeneruar moralisht dhe në aspektin etik, rinia konsumon më shumë se sa prodhon, endacakë, përtac, luftojnë dhe debatojnë ashpër për të drejtat e (LGBT-ve) etj. etj., vaj halli për ne! Vaj halli për shqiptarët/ boshnjakët/ turqit/ ashkalinjtë myslimanë! Vaj halli për ardhmërinë tonë nëse nuk shpejtojmë me reforma fetare, sociale, institucionale të duhura. Do të na kaplon shërra dhe dënimi i madh nga Allahu shkak i përhapjes së këtyre dukurive të këqija dhe shkak i mos reagimit tonë urgjent për t'i shpëtuar ata duke i urdhëruar kah e mira, duke i mësuar, duke i trajnuar për të mirë dhe duke i ndaluar nga e keqja, duke i këshilluar, duke i udhëzuar që mos të zhyten në vepra të ndaluara dhe të këqija.

Qëllimi nga mësim-besimi nëpër mektebe të xhamive të Kosovës dhe gjetiu është ruajtja e identitetit fetar islam nga rreziku i asimilimit fetar, kulturor dhe moral. Shyqyr Allahut xh.sh. dhe të gjitha falënderimet i takojnë Atij për këtë dhunti dhe mirësi ndaj

nesh, elhamdulillah që jemi Mysliman dhe që na ka ruajtur Allahu xh.sh. prej kthetrave të regjimit komunist në ish-Jugosllavinë e Titos komuniste dhe aparaturës ortodokse fanatike serbo-sllave gjate kohës së Rankoviçit dhe të Millosheviçit. Këto mektebe / klasa / zyra / dhoma të vogla të bashkangjitura xhamisë; kanë luajtur rol të madh përgjatë shekujve dhe dekadave gjer më sot në mirëmbajtjen e besimit të Monoteizmit, të Teuhidit të pastër Islam, besimit në një Zot i Cili është i Vetëm, i Cili nuk ka lind askënd - s'ka fëmijë -, dhe i cili Vet nuk është i lindur nga dikush - nuk ka prind - dhe Ai askujt nuk i përngjan, të Cilin e kanë besuar të parët tanë, dhe na e kanë trashëguar neve të pastër e të kulluar si loti i syrit. Ne të gjithë ne jemi borxhli ndaj tyre me lutje të pashkëputura gjer në vdekje. Po ashtu në këtë kontekst duhet falënderuar BIK-un e Kosovës për organizimin e këtyre klasave dhe ligjëratave të mësim-besimit nëpër mektebe, me botimin e revistave Dituria Islame, periodikeve si Edukata Islame, Takvimi etj. Allahu i shpërbleftë.

Tani në këtë kontekst duhet shtruar një pyetje e cila kërkon një përgjigje të madhe dhe serioze. **Pyetja thotë:** A është i mjaftuar mësim-besimi fetar nëpër mektebe për ta sfiduar gjendjen globale dhe aktuale anti-islame anembanë globit? A janë të mjaftueshme botimi i Revistave Islame, Edukatave Islame, Ligjëratat publike javore të Xhumave etj.?

Përgjigjja është: JO, nuk është i mjaftuar ky angazhim dhe këto iniciative, dhe se ky mision që është duke u zhvilluar në mënyre

rutinë nuk është i mjaftueshëm dhe nuk e përmbush zbrazëtirën shpirtërore, morale dhe edukativo arsimore, dhe se gjendja faktike dhe aktuale dëshmon për efektin e dobët dhe jo të mjaftueshëm. Nëse para 50 viteve në kohën e ish-Jugosllavisë nuk kemi poseduar kushte të mjaftueshme për ta zgjeruar misionin edukativo-arsimor për ruajtjen e identitetit tonë fetar Islam dhe atij Kombëtar, sot i posedojmë këto kushte dhe këto resurse humane, mediatike, shkencore, financiare dhe materiale etj. Apeloj urgjentisht që misionin mektebeve ta ngrisim dhe ta transformojmë në misionin e shkollave fillore, të mesme, universitete (fakultete dhe studime post-diplomike). Është imperativ kur'anor dhe profetik që këto Reforma të zhvillohen urgjentisht duke koordinuar me qeverinë dhe liderët politik për t'i bindur ata për rëndësinë dhe vlerën pozitive edukativo-arsimore të këtyre reformave, dhe se BIK-u të jetë konfident me programe për ndryshim pozitiv, guximtar dhe pa kompromis para qeveritareve, t'i sfidoj anti-islamistët, anti-fetarët publikisht gjer të realizohet kjo ëndërr e besimtarëve shqiptar / boshnjakë e të tjerë në Kosove dhe gjetiu, dhe mos të harrojmë se në shtetet demokratike në Evropë kjo ëndërr është realizuar që moti, sepse konsiderohet e drejta humane bazike e njeriut, dhe mos të harrojmë faktin se në Serbinë fqinje, kjo reformë ashtë aktive dhe funksionale që sa vite, ata e kane fut mësim besimin në shkollat publike shtetërore, dhe nuk e kuptoj dot pse pret BIK-u, dhe pse qeveria apo deputetët shqiptarë në parlamentin e Kosovës e anashkalojnë dhe e neglizhojnë këtë të drejtë të popullit! Normal

që pjesa dërmuese e deputeteve janë anti-islamistë, për arsye se ata kanë bindje dhe informata të gabueshme rreth Islamit dhe muslimanëve. Allahu na ndihmoftë në realizimin e këtyre reformave, dhe mos të harrojmë se Allahu xh.sh. në Kuranin Famë-lartë thotë në suren er Ra'd, Ajeti 11 (*All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) për derisa ata ta ndryshojnë veten e tyre*), Po ashtu Allahu xh.sh. në suretu et Teubeh, ajeti 105 (*Dhe thuaj: "Veproni, All-llahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i dërguari i Tij e besimtarët..)*

10. SIPAS MENDIMIT TUAJ KUSH JANË PEDAGOGË ISLAM QË KANË LËNË GJURMËT MË TË MËDHA NË HISTORI TË KOSOVËS, POR EDHE ATË GLOBALE GJATË HISTORISË ISLAME. (T'I NUMËRONI SË PAKU 5-10 VENDOR, (DIJETARË, INTELEKTUAL) DHE 5-10 BOTËRORË TË SHQUAR NË HISTORINË ISLAME POR EDHE TANI NE KOHEN BASHKËKOHORE.)

Pedagogë musliman / shqiptar / boshnjak që kanë lënë gjurmë pozitive në historinë e Kosovës dhe në Ballkan përgjithësi janë shume, e ndër ta po i veçojmë këta pedagogë vendor:

- 1- Hfz.Hoxhë Ali Korca,
- 2- Hfz. Hoxhë Ibrahim Dalliu,
- 3- Imam Muhadith Sheikh Nasiruddin el Albani,
- 4- Imam Muhadith Sheikh Shuajb el Arnaut,
- 5- Imam Muahdith Sheikh Abdul Kadir Arnaut
- 6-Imam Vehbi Gavoçi,
- 7-Hoxhë Sherif Ameti,
- 8-Prof.Dr.Feti Mehdiu,
- 9-Prof.Dr.Husein Gjozo,

10-Presidenti Dr.Alija Izetbegović,

11-Prof.Dr.Enes Kariç,

12.Prof. Dr. Fikret Kariç,

13-Prof.Dr.Muamer Zukorliç

Ndër Pedagoget ndërkombëtarë veçojmë:

1. Imam Sheikh Dr.Jusuf el Kardavi,
2. Prof.Dr.Muhamed Said Ramadan el Buti,
3. Prof. Shehijd Sejjid Kutub,
4. Prof.Muhamed Kutub,
5. Imam Sheikh Muhamed Ali el Sabuni,
6. Imam Sheikh Muhamed el Gazali,
7. Imam Sheikh Muhamed Muteveli el Sha'ravi,
8. Prof.Dr. Wahba el Zuhajli,
9. Mevlana Ebul e'la el Meududij,
10. Prof.Dr. Tarik el Suvejdan,
11. Imam Sheikh Mustafa el Zerka,
12. Imam Sheikh Hasen el Benna,
13. Sheikh Selman el Audah,

14. Sheikh Aid el Karnij,

Në fund them fjalën e Hfz.Ibrahim Dalliut:

**VE MA TEUFIKIJ IL-LA BIL-LAH THEMË - MBARËVAJTËSINË -
TIME & TUAJEN - VETËM NGA ALLAHU DUA TA KEMË... amin,
amin, amin!**

Këto përgjigje i shkroi, robi dhe i varfëri Allahut Fuqiptotë:

Prof.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha,

30 janar 2022

Doha -Katar